



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES

Nr. 83/2 prot.

Tiranë, më 25.3.2025

VENDIM
Nr. 8, datë 25.3.2025

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 79, DATË 18.12.2024

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, ndryshuar me vendimin nr. 158, datë 30.12.2022, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit të Drejtorisë së Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit nr. 79, datë 18.12.2024, të Komisionerit, *“Për verifikimin e ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera nga organi i disiplinës, i ngritur pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve gjatë zhvillimit të procedurës për dhënien e masës disiplinore në ngarkim të nëpunësit civil Gjergji Duro”*.

KONSTATOVA SE:

Përmes shkresës të regjistruar me nr. 806 prot., datë 31.10.2024, nëpunësi civil Gjergji Duro, me detyrë *“Përgjegjës Sektori i Kontrollit në Vend sipas Industrive, në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj, në Drejtorinë Rajonale Tiranë”*, ka informuar Komisionerin, duke ngritur pretendime për shkelje të hapur të ligjit për shërbimin civil nga ana e Komisionit Disiplinor që funksionon pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, gjatë zhvillimit të procesit disiplinor në ngarkim të këtij nëpunësi.

Pas shqyrtimit të të dhënave që përmbante informacioni i përcjellë, Komisioneri ka kryer hetimin administrativ mbi çështjen në fjalë.

Ky proces është përmbyllur me vendimin nr. 79, datë 18.12.2024, të Komisionerit, *“Për verifikimin e ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera nga organi i disiplinës, i*

ngritur pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve gjatë zhvillimit të procedurës për dhënien e masës disiplinore në ngarkim të nëpunësit civil Gjergji Duro”.

Në lidhje me ecurinë e zbatimit të këtij vendimi, njësia përgjegjëse (DAP) ka informuar Komisionerin në lidhje me situatën ligjore dhe faktike të këtij rasti, duke bashkëngjitur dokumentacionin përkatës.

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin nr. 806 prot., datë 31.10.2024, si dhe duke verifikuar dokumentacionin bashkëlidhur shkresës nr. 38/1 prot., datë 21.01.2025, të njësisë përgjegjëse (DAP), rregjistruar me tonën me nr. 83 prot., datë 22.01.2025, konstatoj se situata e administrimit të shërbimit civil për rastin në fjalë paraqitet si më poshtë vijon:

Në pikat 1-3 të dispozitivit të vendimit, objekt i këtij verifikimi, Komisioneri ka kërkuar nga subjektet e ngarkuara nga ligji me detyra të posaçme në administrimin e shërbimit civil të marrin masat si më poshtë:

- Komisioni Disiplinor të konstatojë pavlefshmërinë absolute të vendimit nr.129, datë 13.03.2024, me të cilin është vendosur largimi nga shërbimi civil për Z. Gjergji Duro.
- Drejtori i Përgjithshëm të konstatojë pavlefshmerine absolute të aktit administrativ nr. 2089/2 prot., datë 03.04.2024, për ndërprejen e marrëdhënieve financiare për Z. Gjergji Duro.
- Nëpunësi Gjergji Duro të vijojë marrëdhëniet në shërbimin civil në pozicionin e punës *“Përgjegjës Sektori i Kontrollit në Vend sipas Industrive, në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj, në Drejtorinë Rajonale Tiranë”*.

Nga informacioni i përcjellë përmes shkresës nr. 38/1 prot., datë 21.01.2025 të njësisë përgjegjëse (DAP), rezulton se, z. Gjergji Duro i është drejtuar me kërkesë-padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke thërritur si palë të paditura Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, si dhe Departamentin e Administratës Publike, ku ndër të tjera ka kërkuar: *“Shfuqzimin e aktit administrativ Vendim nr. 129, datë 13.03.2024, lëshuar nga Komisioni i Disiplinës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, si akt i paligjshëm. Urdhërimin e të paditurve për kthimin e paditësit në pozicionin e mëparshëm të punës, me detyrimin për pagimin e pagës...”*

Në kushtet kur çështja do të zgjidhet përfundimisht në rrugë gjyqësore, vlerësoj se, bazuar në nenin 1, pika 2, të ligjit nr.49/2012, *“Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”*, si dhe nenit 36 të Kodit të Procedurës Civile, për shkak të juridiksionit që tashmë i përket gjykatës, zbatimi i këtij vendimi nuk mund të ndiqet më tej nga ana e Komisionerit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, ndryshuar me vendimin nr. 158, datë 30.12.2022, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit nr. 79, datë 18.12.2024, të Komisionerit, “Për verifikimin e ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera nga organi i disiplinës, i ngritur pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve gjatë zhvillimit të procedurës për dhënien e masës disiplinore në ngarkim të nëpunësit civil Gjergji Duro”.
2. Për këtë vendim të njoftohet Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, njësia përgjegjëse Departamenti i Administratës Publike, si dhe z. Gjergji Duro.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha